



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 17.03.2023, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-4955/22, për zyrtarët e lartë znj. Albana Shala-Bunjaku dhe znj. Hyrmete Gashi, Anëtare në Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**

## A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarët e lartë znj. Shala-Bunjaku dhe znj. Gashi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi i jashtëm, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit sipas të cilit, znj. Shala-Bunjaku si Zëvendësuese e Udhëheqësit të Departamenti të Tatimit në Pronë, njëkohësisht është bashkëpronare në kompaninë "KREV – Kosova Real Estate Valuation", e cila si veprimtari ka vlerësimin e pronave të paluajtshme, e të cilën veprimtari e ushtron në bashkëpunim/ortakëri me znj. Hyrmete Gashi.

Më tej sipas raportuesit, me vendim të Ministrit, znj. Shala-Bunjaku është caktuar Kryesuese e Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme, ndërsa znj. Gashi është caktuar anëtare e këtij Këshilli. Raportuesi, gjithashtu ka pretenduar se, caktimi i znj. Shala-Bunjaku si kryesuese dhe znj. Gashi si anëtare e Këshillit, është gjithashtu në kundërshtim me nenin 5, të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2021 për Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitive të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i ka njoftuar palët lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-02-161/23, DPKI-06-02-162/23).

Më pastaj, Agjencia ka kontaktuar me palët në procedurë dhe i ka njoftuar me pretendimet e ngritura lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit, si dhe ka dëgjuar sqarimet e tyre lidhur me pretendimet në fjalë. Me znj. Shala-Bunjaku, është caktuar/mbajtur një takim në Agjenci, me ç ‘rast nga e njëjta janë paraqitur informata shtesë lidhur me rastin në fjalë si dhe ka konfirmuar pretendimet sa i përket pronësisë në kompaninë private si më lartë.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në shkresat e lëndës dhe informacioneve të siguruar, si dhe sqarimeve nga pala, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ka njoftuar palët se, zyrtarët e lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mundën që njëkohësisht të jenë Përfaqësues të Autorizuar në biznes privat, pasi që kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

*1. “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, palët janë pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarrin veprime konkrete në mënyrë që të shmangin papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (Dep-06-Nr.Prot.288/23) me dokumentet përcjellëse (informatat e biznesit), në bazë të së cilave dëshmohet se znj. Shala-Bunjaku dhe znj. Gashi, kanë ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat, e gjithashtu edhe nga pronësia e biznesit në fjalë.

Kurse, sa i përket kufizimit të përcaktuar me nenin 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin përcaktohet se: *“Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.”*, palët përmes shkresës zyrtare (Dep.06 Nr.Prot.370/23) kanë deklaruar se nuk e ushtrojnë funksioni e Vlerësuesit të Pronave as në kuadër të ndonjë kompanie private e as si persona fizik, dhe se aktivitetin në këtë fushë e kanë zhvilluar vetëm sa i përket punës në institucionin shtetëror sipas përshkrimit të detyrave të punës.

Me veprimet e ndërmarra nga palët, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarët e lartë.

Lidhur me pretendimin se, caktimi i znj. Shala-Bunjaku si kryesuese dhe znj. Gashi si anëtare e Këshillit, është gjithashtu në kundërshtim me nenin 5, të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2021 për Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme, Agjencia vlerëson se një gjë e tillë duhet të përcaktohet nga ana e institucionit përkatës/punëdhënës të zyrtareve në fjalë.

Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Ylli Buleshka  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

